

Libri i Kuq i Faunës së Kosovës në Diskutim Publik

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, përkatësisht Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës në kuadër të Programit Mjedisor për Kosovën (KEP 2016) është duke implementuar edhe Komponentin “Mbrojtja e Biodiversitetit përmes Hartimit të Librit të Kuq të Faunës”.

Në kuadër të kësaj komponente pas një pune hulumtuese në terren është përgatitur dokumenti i Librit të Kuq të Faunës së Kosovës.

Bazuar në kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (Nr.03/L-233) përkatësisht të Neni 151 (Pjesëmarrja e publikut në vendim marrje), dokumentet e hartuara në sektorin e natyrës para se të aprovohet dhe publikohet duhet ti nënshtrohen diskutimit publik.

Bazuar në këto kërkesa edhe draft dokumenti i Librit të Kuq të Faunës, i nënshtrohet diskutimit publik. Diskutimi publik do të jetë i hapur nga date 29.08.2019 deri me date 28.09.2019.

Në kuadër të këtij procesi, AMMK angazhimin e të gjithë të interesuarve, në mënyrë të veçantë të ekspertëve dhe shoqatave të ndryshme që me komente dhe rekomandime të ndihmojnë në plotësimin e dokumentit final.

Për komentet, vërejtjet dhe rekomandimet, Ju lutem ti dërgoni në email adresën fadil.bajraktari@rks-gov.net.

Për më shumë:

Draft dokumentin Libri i Kuq i Faunës së Kosovës munde ta shkarkoni ne linkun

http://ammk-rks.net/repository/docs/Libri_i_kuq.pdf